



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 611/3 Prot.

Tiranë, më 12/5/2017

V E N D I M

Nr. 12, datë 12/5/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "PAKT Group" sh.p.k, Tiranë;

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 100 datë 03.04.2017, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "PAKT Group" shpk (nipt **L219180201**) me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri.
- Përpunimi i të dhënave personale në kuadër të implementimit të projektit "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren".

Kontrolluesi "PAKT Group" ka si objekt veprimtarie të deklaruar në QKB, aktivitetin kryesisht në fushën e ndërtimit të objekteve shumëkatësh, pallateve, rikonstruksione godinash etj.

Në kuadër të implementimit të projektit të përbashkët të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) "Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren", OSHEE ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij projekti, ka deleguar përpunimin e të dhënave te përpunuesi "Bashkimi i Operatorëve CSI Piemonte-Consorzio për il sistema informativo, Datech sh.p.k dhe Çelësi sh.p.k (BO)".

Shoqëria "Datech" sh.p.k, si përfaqësuese e BO-së e cila është në rolin e përpunuesit për llogari të kontrolluesit OSHEE, ka nënshkruar një kontratë delegimi me subjektin nënpërpunues "PAKT Group" shpk nëpërmjet të cilës i ka deleguar disa shërbime që kanë të bëjnë me kryerjen nga ana e kontrolluesit të shërbimeve të karakterit administrativ e organizativ për përzgjedhjen, rekrutimin e specialistëve si dhe organizimin dhe mbikëqyrjen e punës në terren.

1. Në zbatim të objektit të parë të Urdhërit të Komisionerit, nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrollues si dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit, rezultoi se kontrolluesi “PAKT Group” nuk kishte përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet:

“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji. Në këto kushte, konsiderohet shkelje serioze përpunimi i të dhënave personale pa njoftuar dhe pa u regjistruar më parë në Regjistrin e subjekteve kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit.

2. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” në të cilën parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

3. Kontrolluesi “PAKT Group” në kontratat e punës me punonjësit që vihen në dijeni të të dhënave personale të qytetarëve në funksion të projektit “Për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren”, nuk ka parashikuar detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar;

Zyra e Komisionerit vlerëson se garantimi i konfidencialitetit është një nga aspektet më të rëndësishëm të të dhënave personale dhe pasojat negative që mund të ketë ndaj subjekteve të të dhënave.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në datën 24/04/2017 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar prapësime në lidhje me konstatimet në procesverbalin e hetimit administrativ, ku pretendon se:

“Lidhur me zbatimin e Nenit 21 të Ligjit 9887 datë 10/03/2008 ju njoftojmë se “Pakt Group” shpk ka bërë njoftimin te Komisioneri më 18/04/2017”. “Pakt Group” shpk në kuadër të zbatimit të kontratës me shoqërinë “Datech” shpk nuk është përgjegjëse për përpunim apo nënpërpunimin të dhënash. Lidhur me zbatimin e Nenit 27 të Ligjit 9887 datë 10/03/2008, ju bëjmë me dije që ne kemi një rregullore të brendshme të cilën ua kemi vënë në dispozicion grupit të hetimit administrativ. E gjithë puna jonë nuk ka të bëjë me të dhëna personale përveç atyre të punëmarrësve. Sa i takon punës tonë me projektin për identifikimin dhe popullimin e adresës për çdo shtetas në terren nuk ka aspak lidhje me përpunimin e të dhënave. Lidhur me zbatimin e Nenit 28 të Ligjit, për ruajtjen e konfidencialitetit, ju bëjmë me dije që është përfshirë në kontratën e bashkëpunimit që kemi me shoqërinë “Datech” – neni 3 (informacioni konfidencial)”.

Lidhur me këto pretendime Zyra e Komisionerit sqaron se:

1-Në lidhje me pretendimin se: subjekti “PAKT Group” shpk nuk është përgjegjës për përpunim apo nënpërpunim të dhënash, nuk qëndron, pasi nga verifikimi i kryer pranë kontrolluesit si dhe nga analizimi i kontratës me subjektin “Datech” rezulton se kemi të bëjmë me një marrëdhënie kontraktore nëndelegimi për përpunimin e të dhënave sipas parashikimit të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 19 datë 03.08.2012 të Komisionerit mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”.

2-Në lidhje me pretendimin se: e gjithë puna jonë nuk ka të bëjë me të dhëna personale përveç atyre të punëmarrësve, nuk qëndron, pasi nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se të dhënat të cilat mblihdeshin nëpërmjet formularëve fizik nga punëmarrësit (intervistuesit) e punësuar nga kontrolluesi “PAKT Group” shpk, përpunoheshin (mblihdeshin) në ambientet e kontrolluesit.

3-Në lidhje me pretendimin se: në zbatim të nenit 27 të Ligjit...kemi një rregullore të brendshme të cilën ua kemi vënë në dispozicion grupit të hetimit administrativ, nuk qëndron, pasi kjo rregullore e brendshme nuk përmbush detyrimet e përcaktuara në Nenin 27 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Hetimi administrativ i ushtruar pranë subjektit “PAKT Group” shpk është kryer për të verifikuar zbatimin e ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, si për rolin e tij si kontrollues në përpunimin e të dhënave po ashtu dhe për rolin e nënpërpunuesit në kuadër të zbatimit të projektit. Aktiviteti i kontrolluesit rezulton se kryhet duke mosrespektuar dispozitat e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 gërmat “d”, “dh”, të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, përbejnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Kontrolluesi "PAKT Group", në formën ligjore të aktivitetit të tij është person juridik dhe sipas nenit 39/2, për kundravajtjet e mësipërme, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave, të drejtën e subjekteve të të dhënave për t'u informuar mbi përpunimin e të dhënave të tyre, masa organizative dhe teknike të përshtatshme që duhet të merren për të mbrojtur të dhënat personale, si dhe për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ dhe në reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 21, 27, 29, 30, 31, 39/1/d, 39/1/dh, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "PAKT Group" shpk me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "PAKT Group" shpk me gjobë, në vlerën **30 000 (tridhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 14, 5 2017.

